



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1341/7 prot.

Datë 26/06/2024

V E N D I M

Nr. 753/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26/06/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Fedos” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-02672-04-25-2024, me objekt: “*BLERJE PAJISJE FIZIOTERAPIE (SIPAS LISTES) PER DSHS-KURBIN*”, me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

Ankimues: Operatori ekonomik “Fedos” SHPK me NIPT: K01514009I dhe me adresë: Rruga “Kujtim Laro”, Nr. Pasurisë 3/22, Kati. 2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin
Adresa: Lagjia Nr 4 Laç - Kurbin.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nwn kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.04.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-02672-04-25-2024, me objekt: “*BLERJE PAJISJE FIZIOTERAPIE (SIPAS LISTES) PER DSHS-KURBIN*”, me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.

II.2. Në datë 07.05.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 20.05.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “ <i>AlMedical</i> ” SHPK	0 leke	skualifikuar
2. “ <i>FEDOS</i> ” SHPK	1.600.000 leke	skualifikuar
3. “ <i>EUROMED</i> ” SHPK	2.124.900 leke	kualifikuar
4. “ <i>CFO PHARMA</i> ” SHPK	2.495.000 leke	kualifikuar

II.4. Në datën 20.05.2024, operatori ekonomik “FEDOS” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Në zbatim të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në fuqi dhe VKM-së nr. 285, datë.19.12.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nga vlerësimi i ofertës tuaj sipas kriterëve të DST –së . Oferta juaj u vlerësua me kujdes në bazë të kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në Njoftimin e Kontratës dhe dosjen e ofertës. Ju informojmë se jeni skualifikuar pasi oferta e paraqitur nga ju është refuzuar për mungesë sasive në të artikujve në dokumentacion për arsyen (et) e mëposhtme:

1- Shtojcën Nr.2 Listën e Çmimeve keni sjellë ofertën vetëm për 1 Tens. Ndërsa Lista e çmimeve në DST është për 3 Tens. Pra në ofertën tuaj mungojnë 2 Tens. Duke ju falenderuar për pjesmarrjen tuaj.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 24.05.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “EUROMED” SHPK.

II.6. Në datën 29.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/4129 dhe me nr. 1341 prot., datë 29.05.2024, e operatorit ekonomik “FEDOS” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1341/2, datë 30.05.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 173/13 prot, datë 04.06.2024, të tërguar nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike dhe e protokolluar me tonën me nr. 1341/3 prot datë 04.06.2024, si dhe nëpërmjet po të njëjëtës shkresë me nr. 173/13 prot, datë 04.06.2024, të tërguar nëpërmjet shërbimit postar dhe e protokolluar me tonën me nr. 1341/4 prot datë 06.06.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.9. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit me shkresën nr. 173/13 prot, datë 04.06.2024, ka vendosur:

“ [...] ... Refuzimin e ankesës së Operatorit Ekonomik “FEDOS” shpk. ... [...]”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se: “- Shoqëria FEDOS sh.p.k., (ankuesi) konstaton se veprimet e autoritetit kontraktor janë kryer në kundërshtim me parimet dhe rregullat e vlerësimit të ofertave, të përcaktuara në Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton se “(...); 1- Shtojcën Nr.2 Listën e çmimeve keni sjellë ofertën vetëm për 1 Tens . Ndërsa Lista e Çmimeve në DST është për 3 Tens. Pra në ofertën tuaj mungojnë 2 Tens. (...);”. Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, ndër të tjera, dokumentet standarde të tenderit dhe procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim. Në shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, për artikullin me numër rendor “2” është kërkuar si më poshtë:

2	Tens	<p><i>I lehte per tu perdorur neper stimuli terapeutik.Te jete i pajisur paraprakisht me game te gjere te protokolleve te paracaktuara per elektroterapi. Planifikimi i sekuences se fazave te trajtimit persecilin kanal.Te kete 2 kanale dales te pavarur per stimulim te diferenciuar. Kontroll sigurie me aktivizimin e rrymes ne rast te shkepuljes aksidentale Te elektrodave.Trajtimi i kushteve inflamatore te muskujve, artikulacioneve,nervave periferike dhe,te traumave dhe hematomave.Lloji I vales te jete min bifazike•drejtkendore.</i></p> <ul style="list-style-type: none"><i>Rryma e vazhdueshme 20mA-30mA</i>	Tens	30 dite nga Nenshkrimi I Kontrates
---	------	--	------	------------------------------------

	<ul style="list-style-type: none"> • Rryma pulsuese 60mA-70mA • Tensioni maksimal I daljes 100Vdc • Furnizimi me energji elektrike 90·240Vac/50-60 Hz Te jete i pajisur me aksesoret: • Elektrode gome perçuse 80 x 120 mm 4 cope Elektrode gome peçuese 45 x 60 mm 4 cope 		
--	---	--	--

Në vijim, bëjmë me dije se gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike, sa i takon sasisë dhe grafikut të lëvrimit operatori ekonomik FEDOS sh.p.k. i është referuar dokumenteve të tenderit, duke ofertuar për sasinë e kërkuar sipas formularit të sasisë dhe grafikut të lëvrimit (Shtojca nr.6), të publikuar nga AK për procedurën objekt ankimi. Qëndrimi i autoritetit kontraktor, se sasia e ofertuar për artikullin me nr. rendor “2” (Tens) është e ndryshme nga ajo e përcaktuar sipas Shtojcës nr. 2 “Lista e Çmimeve të artikujve” është kontradiktor dhe bie ndesh me shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, nenin 80 të LPP dhe nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. ...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në Seksioni I: “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, pika B/4 “PËRGATITJA E OFERTAVE” dhe pika B/10 “PËRGATITJA E OFERTAVE” të dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

4. Formularët e Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me tenderit dhe Listat Çmimeve formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me bojë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme dhe të printuar duhet të pajisen me inicialet ose të nënshkruhen nga Personi (at) e Autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i nënshkruar nga Personat e Autorizuar.

10. Formatit dhe Nënshkrimi i Ofertave Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.

III.1.3. Në shtojcën 2 “LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar formularin e ofertës qw duhet të paraqesin operatorët ekonomikë ofertues, si më poshtë vijon:

Shtojca2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallratduhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimevepër artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1	ULTRA-TINGULL	1			
2	TENS	3			
3	TECHAR TERAPI	1			
4	SHOCK WAVE	1			
Çmimi total (Mallrat)					
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë					

III.1.4. Në shtojcën 5 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike dhe sasinw e mallrave objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]
FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr	Modeli	Pershkrimi	Sasia
1	Pajisje per terapi me ultratinguj	<p>I lehte per tu perdorur ne cdo suate per stimulim muskular dhe terapeutik. Aparature per terapi me ultratinguj e programueshme me akordim automatik per te perdorur transduktore me ultratinguj ne intervalin 1 Mhz-3 MHz.Terapi ultratinguj me intensitet te programueshem te vazhdueshme ose te moduluar.</p> <p>Gama e gjeree protokolleve te paracaktuara me Programe te personalizuar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Frekuenca ne dalje 1 -3MHz • Lntensiteti maksimal 3.0W/cmq • Rryma direkte 25mA*-30mA* • Rryma pulsuese 60mA•-70mA* • Tensioni maksimal I daljes 100Vdc* • Njohja automatike e aksesorit te lidhur <p>Tejete i pajisur me Transduktoreme frekuence automatike 1-3MHz-03Smm</p>	1
2	Tens	<p>I lehte per tu perdorur neper stimuli terapeutik.Te jete i pajisur paraprakisht me game te gjere te protokolleve te paracaktuara per elektroterapi. Planifikimi i sekuences se fazave te trajtimit perseclilin kanal.Te kete 2 kanale dales te pavarur per stimulim te diferenciuar. Kontroll sigurie me aktivizimin e rrymes ne rast te shkepuljes aksidentale Te elektrodave.Trajtimi i kushteve inflamatore te muskujve, artikulacioneve,nervave periferike dhe,te traumave dhe hematomave.Lloji I vales te jete min bifazike•drejtkendore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rryma e vazhdueshme 20mA-30mA • Rryma pulsuese 60mA-70mA • Tensioni maksimal I daljes 100Vdc <p>• Furnizimi me energji elektrike90·240Vac/50-60 Hz Te jete i pajisur me aksesoret:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Elektrode gome perçuse 80 x 120 mm 4 cope • Elektrode gome peçuese 45 x 60 mm 4 cope 	1

3	TECAR	<p>I lehte per t'u perdorur,me ekran tip LCD me prekje,.Stimulon reagimin natyror dhe fiziologjik dhe pershejton proceset riparuese,Trajtimi diatermik terapeutik rezistent dhe kapacitiv</p> <ul style="list-style-type: none"> • Game e gjere e protokolleve te paracaktuara • Programe te personalizuar • Modalitet I kapacitiv dhe rezistiv • Doreze me tre pozicione • Fuqia maksimale 150W/250VA • Gama e frekuences 500kHz/1MHz • Furnizimi me energji elektrike 90·240Vac/50·60Hz • Te jete i pajisur me aksesoret: • Elektrode neutral çeliku160x240mm me kablllo 3mt • Doreze 1cope • 3 koka capacitive per dorezen2 4-48·62 3 koka resistive per dorezen 24-48-62 	1
4	Shock wave	<p>Stimulon reagimin natyror dhe fiziologjik dhe pershejton Proceset riparuese, Shockwave konsiston ne gjenerimin e nje vale akustike I rregullueshem ne nje game te caktuar frekuence.i pershejtuar ne dorezen, gjeneron nje vale presioni mekanik qe transferohet ne nje zone specifike duke krijuar reaksione biostimulimi ne inde.me kater modalitete vazhdueshem 4/8/12 pulse)</p> <p>I lehte per t'u perdorur,me ekran tip LCD me prekje,. Shume llojshmeri programesh te para vendosura dhe te programueshme</p> <p>Energjia 60-185 mJ Frekuenca 1-22Hz Ushqimi 90-240 Vac/50-60Hz Te jete i pajisur me aksesoret: Doreze 1 cope Mbrojtese per dorezen Koka per dorezen D.6mm(1 cope)-0.15mm(1cope)•0.25mm (1cope) Pedale kembe1cope</p>	1

Specifikimet Teknike të Përgjithshme

- *Garancia e mallit duhet të jetë jo më e vogël se 2 (dy) vite.*
- *Kerkohet autodeklarate për pajisjet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) për konformitetin me normat CE ose FDA, originale ose fotokopje të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.*
- *Autorizim nga MAH/Prodhuesi/Distributori zyrtar*
- *Katalogje origjinale ose të noterizuara për të gjithë artikujt dhe të markohen artikujt që ofrohen.*
- *Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.*
- *Të gjithë mallrat duhet të jenë sipas specifikimeve.*

Sasia dhe Grafiku i levrimit:

*Afati i levrimit për **30 Dite** nga Nenshkrimi i Kontrates.*

III.1.5. Në shtojcën 6 “**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar sasinw e mallrave objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)
 (Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor
 vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia dhe Grafiku i levrimit:

Afati i levrimit të mallrave do të jetë për **30 Dite** nga Nenshkrimi i Kontrate në DSHS-KURBIN sipas sasive dhe specifikimeve teknike në DST.

Nr	Modeli	Pershkrimi	Sasia	Afati I levrimit
1	Pajisje per terapi me ultratinguj	<p>I lehte per tu perdorur ne cdo suate per stimulim muskular dhe terapeutik. Aparature per terapi me ultratinguj e programueshme me akordim automatik per te perdorur transduktore me ultratinguj ne intervalin 1 Mhz-3 MHz.Terapi ultratinguj me intensitet te programueshem te vazhdueshme ose te moduluar.</p> <p>Gama e gjeree protokolleve te paracaktuara me Programe te personalizuar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Frekuenca ne dalje 1 -3MHz • Lntensiteti maksimal 3.0W/cmq • Rryma direkte 25mA*-30mA* • Rryma pulsuese 60mA•-70mA* • Tensioni maksimal I daljes 100Vdc* • Njohja automatike e aksesorit te lidhur <p>Tejete i pajisur me Transduktoreme frekuence automatike 1-3MHz-03Smm</p>	1	30 dite nga Nenshkrimi I Kontrates
2	Tens	<p>I lehte per tu perdorur neper stimuli terapeutik.Te jete i pajisur paraprakisht me game te gjere te protokolleve te paracaktuara per elektroterapi. Planifikimi i sekuences se fazave te trajtimit perseclin kanal.Te kete 2 kanale dales te pavarur per stimulim te diferenciuar.</p> <p>Kontroll sigurie me aktivizimin e rrymes ne rast te shkepuljes aksidentale Te elektrodave.Trajtimi i kushteve inflamatore te muskujve, artikulacioneve,nervave periferike dhe,te traumave dhe hematomave.Lloji I vales te jete min bifazike•drejtkendore.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rryma e vazhdueshme 20mA-30mA Rryma pulsuese 60mA-70mA • Tensioni maksimal I daljes 100Vdc • Furnizimi me energji elektrike90·240Vac/50·60 Hz Te jete i pajisur me aksesoret: • Elektrode gome perçuse 80 x 120 mm 4 cope Elektrode gome peçuese 45 x 60 mm 4 cope 	Tens	30 dite nga Nenshkrimi I Kontrates

3	TECAR	<p>I lehte per t'u perdorur,me ekran tip LCD me prekje,,Stimulon reagimin natyror dhe fiziologjik dhe pershpejton proceset riparuese,Trajtimi diatermik terapeutik rezistent dhe kapacitiv</p> <ul style="list-style-type: none"> • Game e gjere e protokolleve te paracaktuara • Programe te personalizuara • Modalitet I kapacitiv dhe rezistiv • Doreze me tre pozicione • Fuqia maksimale 150W/250VA • Gama e frekuenes 500kHz/1MHz • Furnizimi me energji elektrike 90-240Vac/50-60Hz • Te jete i pajisur me aksesoret: • Elektrode neutral çeliku160x240mm me kablllo 3mt • Doreze 1cope • 3 koka kapacitive per dorezen2 4-48-62 3 koka resistive per dorezen 24-48-62 	1	30 dite nga Nenshkrimi I Kontrates
4	Shock wave	<p>Stimulon reagimin natyror dhe fiziologjik dhe pershpejton Proceset riparuese, Shockwave konsiston ne gjenerimin e nje vale akustike I rregullueshem ne nje game te caktuar frekuenca.i pershpejtuar ne dorezen, gjeneron nje vale presioni mekanik qe transferohet ne nje zone specifike duke krijuar reaksione biostimulimi ne inde.me kater modalitete vazhdueshem 4/8/12 pulse)</p> <p>I lehte per t'u perdorur,me ekran tip LCD me prekje,. Shume llojshmeri programesh te para vendosura dhe te programueshme</p> <p>Energjia 60-185 mJ Frekuenca 1-22Hz Ushqimi 90-240 Vac/50-60Hz Te jete i pajisur me aksesoret: Doreze 1 cope Mbrojtese per dorezen Koka per dorezen D.6mm(1 cope)-0.15mm(1cope)•0.25mm (1cope) Pedale kembe1cope</p>	1	30 dite nga Nenshkrimi I Kontrates

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.5. Në nenin 14, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik”.

III.1.6. Në nenin 74, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e dokumenteve të tenderit përdor dokumentet standarde sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike. Autoriteti ose enti kontraktor publikon në Sistemin e Prokurimit Elektronik dokumentet, të cilat gjenerohen automatikisht në përputhje me llojin e procedurës së zgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, si edhe në përputhje me formën dhe standardin e Bashkimit Evropian.”.

III.1.6. Në nenin 15 “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Dokumentet standarde të tenderit përmbajnë informacionin e përgjithshëm dhe informacionin specifik.

2. Informacioni i përgjithshëm përgatitet sipas formularëve përkatës, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit. Ky informacion përfshin të paktën:

- njoftimin paraprak të informacionit/njoftimin periodik të informacionit;
- njoftimin e kontratës;
- ftesën për ofertë (në rastet e procedurave me faza);
- udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- formulari përmbledhës i vetëdeklarimit;
- deklaratën e konfliktit të interesit;
- deklaratën e informacionit konfidencial;
- formularin e ofertës ekonomike;
- sigurimin e ofertës;
- njoftimin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- njoftimin e fituesit;

- formularin e ankesës;
- modelin e marrëveshjes kuadër;
- njoftim për lidhjen e marrëveshjes kuadër;
- model kontrate, ku përfshihen kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të propozuara të kontratës;
- sigurimin e kontratës;
- njoftimin e lidhjes së kontratës;
- njoftimin e anulimit të procedurës.

3. Informacioni specifik përmban informacion për kontratat e punëve, mallrave dhe shërbimeve:

a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:

- projektin dhe specifikimet;
- preventivin e hollësishëm dhe strukturën e kostos mënyrën e paraqitjes së ofertës;
- grafikun e zbatimit;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

b) Informacioni specifik për kontratat e mallrave përfshin të paktën:

- specifikimet teknike;
- grafikun e livrimit
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.

c) Informacioni specifik për kontratat e shërbimeve përfshin të paktën:

- termat e referencës;
- grafikun e ekzekutimit;
- kërkesat për personelin kryesor;
- kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.”.

III.1.7. Në nenin 24 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët” pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, nga pjesëmarrësit bazuar në dokumentet standarde të tenderit.”.

III.1.8. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të livrojë, si dhe grafikun e livrimit të mallrave.”.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përdorur dokumentat e tenderit standarde të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, si dhe ka përcaktuar llojin dhe

sasinë e mallrave objekt prokurimi dhe konkretisht në Shtojcën 2 “*LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE*” ka përcaktuar se do të blejë artikujt me emërtimin dhe sasinë si në vijim: “1- Produktin ‘*ULTRA-TINGULL*’ për një sasi prej 1 (një) copë; 2- Produktin ‘*TENS*’ për një sasi prej 3 (tre) copë; 3- Produktin ‘*TECHAR TERAPI*’ për një sasi prej 1 (një) copë dhe 4- Produktin ‘*SHOCK WAVE*’ për një sasi prej 1 (një) copë.”, ndërsa në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” ka përcaktuar se do të blejë artikujt me emërtimin dhe sasinë si në vijim: “1- Produktin ‘*Pajisje per terapi me ultratinguj*’ për një sasi prej 1 (një) copë; 2- Produktin ‘*TENS*’ sasi e papwrcaktuar; 3- Produktin ‘*TECHAR*’ për një sasi prej 1 (një) copë dhe 4- Produktin ‘*SHOCK WAVE*’ për një sasi prej 1 (një) copë.”, duke publikuar dy sasi të ndryshme për artikullin “TENS” objekt prokurimi.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore duhet të hartojnë dokumentat e tenderit në përputhje me përcaktimet e bazës ligjore të sipërpërmendur, duke përcaktuar saktë në shtojcën përkatëse përshkrimin dhe sasinë e mallrave objekt prokurimi dhe për më tepër këto përcaktime duhet të pasqyrohen me korrektësi në shtojcën përkatëse të formularit të ofertës, pasi në këto dy dokumenta operatorët ekonomik ofertues marrin informacionin e nevojshëm për të përgatitur ofertën e tyre ekonomike.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i saktë dhe me korrektësi i i përshkrimit dhe sasisë së mallrave objekt prokurimi është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje gjetjet nga testimi i tregut dhe argumentimi i fondit limit, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me këtë argumentim.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk i ka hartuar dokumentat e tenderit në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, pasi në Shtojcën 2 “*LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE*” të dokumentave të tenderit për artikullin objekt prokurimi “TENS” ka përcaktuar se ka nevojë për të blerë një sasi prej 3 (tre) copë, ndërsa në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar sasinë që kërkon të blejë për artikullin “TENS” objekt prokurimi, duke vënë në vështirësi jo vetëm ofertuesin lidhur me hartimin e ofertës së tij ekonomike, por edhe Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ankimesit.

KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentat e tenderit të mësipërm në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se sasinë e mallrave që prokurohen nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen qartë në shtojcën përkatëse të këtyre dokumentave dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik ofertues në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

III.1.10. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se mospërputhja e krijuar midis kërkesave të parashikuara nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike e kritereve të kualifikimit, pjesë e dokumentave të tenderit, ndikon drejtpërdrejtë në hartimin e ofertës ekonomike të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe në vlerësimin e ofertave nga ana e KVO-së, si dhe është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “FEDOS” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-02672-04-25-2024, me objekt: “BLERJE PAJISJE FIZIOTERAPIE (SIPAS LISTES) PER DSHS-KURBIN”, me fond limit 2.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*FEDOS*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

